



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.05.2019, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Raporti i veprimtarisë vjetore të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2018.
2. Raporti i veprimtarisë vjetore të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2018.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Dritan Bici, Evis Kushi, Ervin Bushati, Anastas Angjeli, Vullnet Sinaj, Arben Elezi, Senida Mesi, Amra Barova.

Mungon:

Ilir Xhakolli

Të ftuar:

Genci Mamani - Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

Martin Blushi - Koordinator në GKSF

Ermila Petoshati - Përgjegjëse e Sektorit Juridik

Arben Beja - Përgjegjës i Sektorit të Analizës së Riskut

Evis Shurdha - Kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik

Brunilda Ali - Inspektore në Komisionin e Prokurimit Publik

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Sot në rendin e ditës së këtij komisioni kemi raportin e veprimtarisë vjetore të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2018.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi raportin e veprimtarisë vjetore të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2018.

Të ftuar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave kemi zotin Genci Mamani, drejtor i Përgjithshëm, zotin Martin Blushi, koordinator, zonjën Ermila Petoshati, përgjegjëse sektori, dhe zotin Arben Beja, përgjegjës sektori.

Atëherë, vazhdojmë me relatorin për të paraqitur raportin dhe më pas me drejtorin e Përgjithshëm.

Fjala është për ju, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Kuvendi, duke vlerësuar rolin e Agjencisë në shërbim të sigurimit të gatishmërisë operacionale dhe vigjilencës ndaj çdo situatë që mund të ketë ndikim në stabilitetin financiar në vend; ruajtjes së stabiliteti financiar dhe shmangies së krizave të mundshme financiare, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit përfundimtar të shërbimeve bankare, nëpërmjet ndërtimit të urave të komunikimit ndërmjet autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse të sistemit bankar shqiptar; rolit të ri që iu caktua me ligjin nr.133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë” si administratore e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, konstaton se gjatë vitit 2018 Agjencia ka vijuar të mbetet e angazhuar në drejtim të përmbushjes me eficiencë të mandatit të saj ligjor. E udhëhequr edhe nga rekomandimet e lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për këtë vit; ka vijuar bashkëpunimin ndër-institucional si anëtar i Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, ka qenë në kontakt konsultimi të vazhdueshëm me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave, si partnerët strategjikë parësorë të Agjencisë në drejtim të objektivit të përbashkët të stabilitetit

financiar; si dhe ka konsideruar dhe ka marrë masa për respektimin dhe vënien në zbatim për vitin 2018 edhe të rekomandimeve të Kuvendit.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i rekomandon Agjencisë së Sigurimit të Depozitave që gjatë vitit 2019, në zbatim të përcaktimeve ligjore dhe duke marrë në konsideratë kushtet ekonomike dhe sociale të Republikës së Shqipërisë dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të sigurimit të depozitave, të shqyrtojë dhe të vlerësojë përshtatshmërinë e treguesve të skemës së sigurimit të depozitave, duke përfshirë, ndër të tjera normën e primit të sigurimit, nivelin e mbulimit për depozitat e siguruara, kategoritë e depozitave të sigurueshme dhe atyre të përjashtuara nga sigurimi si dhe raportin e synuar të mjaftueshmërisë së fondeve që Agjencia administron; të vijojë testimin e sistemit për sa i takon gatishmërisë në rast ngjarje; sigurimin e infrastrukturës së IT-së, komunikimin me depozituesit, ashtu dhe me bankën agjente të përzgjedhur nga Agjencia për kryerjen e një procesi kompensimi, duke kryer simulime teknike dhe tematike, si dhe duke u angazhuar në simulimet ndërinstitucionale apo simulimet për raste të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me qëllim testimin e procedurave operacionale të hartuara në letër, dhe, së fundi, të thellojë më tej bashkëpunimin me Grupin Këshillimor të Stabilitetit Financiar, në veçanti me Bankën e Shqipërisë, duke marrë në konsideratë rolin kyç të këtij institucioni, si autoriteti përgjegjës rregullator dhe mbikëqyrës i sektorit bankar dhe financiar, dhe misionin e përbashkët të dy institucioneve në drejtim të zhvillimit të një sistemi financiar të shëndetshëm në shërbim të publikut dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së tij.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Bushati!

Fjala për ju, zoti Mamani.

Genci Mamani – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar i Komisionit,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Fillimisht më lejoni t’ju falënderoj, në emër të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për bashkëpunimin e frytshëm dhe kontributin e Kuvendit të Shqipërisë, dhe Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, në veçanti në këto vite, në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të skemës së sigurimit të depozitave dhe mbështetjes së dhënë për projektet kryesore të Agjencisë.

Si fillim, përpara se t’ju prezantoj një përmbledhje të aktiviteteve të Agjencisë gjatë vitit 2018, në raportim dhe të bëjë një pasqyrë të skemës së sigurimit të depozitave, më lejoni të

sjell në vëmendjen tuaj rekomandimet e rezolutës së fundit të Kuvendit për veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, si dhe veprimet konkrete të Agjencisë për vënien e tyre në zbatim.

Në lidhje me rekomandimin e parë, i cili kishte të bënte me transparencën dhe bërjen publike të vendimmarrjes së Këshillit Drejtues të Agjencisë, ne kemi hartuar rregulla dhe procedura të qarta për publikimin e vendimeve të miratuara nga Këshilli Drejtues. Që në fillim të vitit të kaluar e gjithë vendimmarrja e Këshillit Drejtues publikohet në faqen tonë zyrtare të internetit. Ky publikim përcillet për publikun dhe të gjithë të interesuarit në dy forma: nëpërmjet një njoftimi, i cili përmbledh çështjet kryesore të trajtuara dhe të miratuara nga Këshilli Drejtues, si dhe duke publikuar vendimet e marra në mbledhjet periodike të Këshillit. Gjithashtu, duke synuar një transparencë sa më të plotë me publikun dhe operatorët e tregut bankar, të gjitha amendimet e Këshillit Drejtues, që prekin anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave, publikohen në fletoren zyrtare.

Rekomandimi i dytë përcaktonte se Agjencia duhej të monitoronte në vazhdimësi plotësimin e kushteve në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi nga ana e shoqërive të kursim-kreditit, në nxitje të një biznesi të shëndetshëm dhe afatgjatë.

Në respekt të ligjit dhe në përputhje me këtë rekomandim të Kuvendit të Shqipërisë, gjatë vitit 2018 kemi monitoruar me kujdes situatën në të gjitha shoqëritë e kursim-kreditit, duke kryer verifikime për të parë sigurimin e dispozitave, që kuadër ligjor dhe rregullativ në fuqi i ngarkon Agjencisë. Këto verifikime kanë përfshirë pa përjashtim të gjitha shoqëritë e kursim-kreditit, duke marrë në konsideratë faktin se këto institucione financiare janë bërë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave prej janarit të vitit 2017.

Në vijim të këtyre verifikimeve të plota, të cilat kanë përfshirë veprimtarinë e sh.p.k-ve si në vitin 2017, ashtu edhe në vitin 2018, kemi hartuar raporte me gjetjet e identifikuar dhe rekomandime për adresimin e tyre. Bazuar në planet e punës për monitorimin e këtij sektori kemi ndjekur në vazhdimësi detyrat e lëna.

Në kuadër të rekomandimit me të cilin i kërkohet Agjencisë të shtojë mjetet e promovimit të skemës së sigurimit të depozitave dhe të vlerësojë impaktin e fushatave promovuese te publiku i targetuar me anë të anketimeve të përvitshme, ju informoj se, në funksion të zbatimit të këtij rekomandimi dhe duke ndjekur drejtimit e përcaktuara në

strategjinë tonë për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut gjatë vitit 2018, kemi pasur një përjasje shumë të fokusuar.

Duke marrë në konsideratë edhe rezultatet e anketimeve të zhvilluara në fokus të aktiviteteve për komunikimin me publikun dhe ndërgjegjësimin e tij në lidhje me elementet e skemës së sigurimit të depozitave kanë qenë kryesisht studentët. Përzgjedhja e këtij target grupi ka synuar transmetimin e mesazhit të kjo kategori, e cila konsiderohet si depozitues potencial. Në të njëjtën kohë kjo formë komunikimi na ka dhënë mundësinë që të ndërveprojmë drejtpërdrejt me këtë target grup. Në këtë drejtim kemi zhvilluar dhe kemi organizuar leksione të hapura dhe debate tematike me studentët e universiteteve publike dhe private, kryesisht të profilit bankë dhe financë.

Sa më sipër, në funksion të objektivave publike të skemës së sigurimit të depozitave për mbrojtjen e interesave të depozituesve dhe për kontributin në stabilitetin bankar dhe financiar, kemi vazhduar të bashkëpunojmë me të gjithë anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave për një informim sa më të mirë dhe të saktë të depozituesve në lidhje me përfitimet dhe kufizimet e skemës së sigurimit të depozitave.

Sipas rekomandimit të radhës, kërkohet që Agjencia të përditësojë politikat dhe procedurat operationale në drejtim të përputhshmërisë së skemës së sigurimit me parimet themelore të skemave efektive të sigurimit të depozitave.

Në lidhje me këtë rekomandim, gjatë vitit 2018 kemi realizuar disa aktivitete operationale, të cilat kanë pasur si qëllim rritjen e efikasitetit rregullator dhe profesional në drejtim të përputhshmërisë me standardet e përcaktuara në fushën e sigurimit të depozitave. Këto aktivitete operationale kanë qenë dy ushtrime simulimi të një ngjarjeje sigurie. Në ndryshim nga simulimet e mëparshme, simulimet e vitit të kaluar mund të them se janë realizuar në një kontekst gjithëpërfshirës, duke qenë se pjesë e tyre ishin: një prej bankave agjente të përzgjedhur në listën paraprake për procesin e kompensimit; përfaqësues të autoritetit mbikëqyrës, si dhe i gjithë personeli i Fondit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës.

Simulimet e kryera e arritën qëllimin e tyre, pasi kanë prodhuar një set me gjetje dhe rekomandime, të cilat do të përfshihen në kuadrin rregullativ të Agjencisë.

Gjithashtu, çështjet e evidentuara janë listuar në një planveprimi me afate konkrete, i cili, në përputhje me objektivat e planit strategjik afatmesëm, vlerësojmë se do t'i avancojë më

tej kapacitetet tona profesionale në përmbushje të mandatit ligjor dhe në përputhje me parimet themelore të skemave efektive të sigurimit të depozitave.

Rekomandimi radhës i kërkon Agjencisë të vazhdojë bashkëpunimin me anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare dhe shoqëritë e kursim-kreditit për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend dhe mbrojtjen e interesave të depozituesve.

Ju informoj se Agjencia e Sigurimit të Depozitave është në çdo kohë shumë e angazhuar të bashkëpunojë me gjithë anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar në vend dhe krijimin e një mjedisi financiar sa më të qëndrueshëm me depozituesit.

Në këtë drejtim, ne kemi ngritur linja të rregullta bashkëpunimi me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë. Si pjesë e grupit këshillimor të stabilitetit financiar, gjatë vitit 2018 kemi marrë pjesë rregullisht në të gjitha mbledhjet e këtij forumi të rëndësishëm, duke raportuar në mënyrë të detajuar për ecurinë e depozitave në sistemin financiar. Gjithashtu, jemi angazhuar në aktivitete të përbashkëta, të cilat kanë pasur si qëllim adresimin e ngjarjeve financiare, të cilat potencialisht mund të kërkojnë ndërhyrjen e autoriteteve mbikëqyrëse.

Rekomandimi i fundit i rezolutës parashikon se Agjencia duhet të mirinformojë depozituesit në lidhje me masat e ndërmarra nga ana e Bankës së Shqipërisë në kuadër të strategjisë së deeuroizimit.

Në zbatim të këtij rekomandimi dhe duke marrë në konsideratë paketën e masave të autoritetit mbikëqyrës për deeuroizimin, gjatë vitit 2018 jemi angazhuar në informimin e depozituesve për elementet e paketës së masave dhe për rreziqet që vijnë nga përdorimi i euros si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit. Në lidhje me këtë, kemi përdorur kanalet dhe mjetet tona të komunikimit, duke e përfshirë atë në të gjitha aktivitetet dhe prezantimet e zhvilluara me grupet e interesit për ndërgjegjësimin e tyre.

Të nderuar deputetë,

Këto ishin rekomandimet e dhëna nga rezoluta e Kuvendit dhe hapat e ndërmarra nga Agjencia për plotësimin e tyre, të cilat përbëjnë edhe pjesën më të rëndësishme të aktivitetit tonë gjatë vitit të kaluar.

Në vijim do të doja të sillja në vëmendjen tuaj një përmbledhje të treguesve kryesorë të depozitave të sistemit bankar dhe financiar, si dhe të skemës së sigurimit të depozitave në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2018 sistemi financiar shqiptar vazhdoi të mbetej i qëndrueshëm, duke krijuar kushtet për një veprimtari të shëndetshme bankare.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2018 ka siguruar depozitat e depozituesve në 16 bankat e sistemit, si dhe në 6 shoqëri kursim-krediti. Por gjatë vitit të kaluar sistemi bankar kaloi një fazë ristrukturimi, si pasojë e bashkimit me përthithje të disa operatorëve bankarë. Gjithashtu, ju informoj se gjatë muajit tetor të vitit 2018 numri i bankave që sigurohen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave është 14.

Në fund të vitit 2018 totali i depozitave në sistemin financiar, përfshirë depozitat e bankave dhe ato të shoqërive të kursim-kreditit, arritën në shifrën prej 1128 miliardë lekësh, duke shënuar një rritje vjetore pre 0,6%. Pa dyshim që pjesën më të madhe e zënë depozitat e bankave me rreth 99,4%.

Sipas të dhënave të publikuara në fund të vitit 2018, Agjencia ka detyrimin e kompensimit të depozitave në banka dhe SHKK, me 672,36 miliardë lekë apo të 1 milion e 617509 depozituesve në sistemin financiar. Në totalin e detyrimeve të Agjencisë ndaj depozituesve, që kanë vendosur depozitat e tyre në banka dhe SHKK, si në vlerë apo në numër depozituesish, raportet janë: 99,2% e zë detyrimi i Agjencisë ndaj depozituesve në banka dhe 0,8% e zë detyrimi i Agjencisë ndaj depozituesve në shoqëritë e kursim-kreditit.

Për sa u takon depozitave në sistemin bankar, në fund të vitit 2018 janë rritur me rreth 0,5%.

Më 31 dhjetor të vitit 2018 totali i depozitave në sistemin bankar rezulton të jetë 1121 miliardë lekë.

Në fund të vitit 2018 vlera e depozitave të lejuara nga ligji për t'u siguruar arrin në 1079 miliardë lekësh, duke përfaqësuar 96,3% të totalit të depozitave.

Rritja vjetore e kësaj kategorie dhe depozitave kanë ndjekur të njëjtin trend në totalin e depozitave, pra me rreth 0,5%.

Depozitat e sigurueshme në lekë, në fund të dhjetorit 2018, zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave me rreth 48.6%, ndjekur nga depozitat në euro me 44,4% dhe depozitat në USD 5,1%.

Depozitat e sigurueshme të individëve në sistemin bankar më 31 dhjetor arritën në 922 miliardë lekë, duke përfaqësuar 85,5% të totalit të depozitave të sigurueshme.

Gjatë periudhës në raportim depozitat e sigurueshme të individëve në lekë në sistemin bankar përfaqësonin 49,8% të depozitave të individëve. Krahësuar me një vit më parë, janë rritur me 0,2%.

Numri i depozituesve individë që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave në sistemin bankar në fund të vitit 2018 ishte 1 milion e 447 mijë e 564, duke përjashtuar depozituesin me balancë nga 0 deri në 100 lekë, të cilët nuk përfitojnë kompensim sipas ligjit.

Për sa u takon depozitave të sigurueshme të tregtarëve dhe shoqërive tregtare në sistemin bankar në fund të vitit 2018 arritën 156,8 miliardë lekë, duke u rritur me rreth 3,8%.

Depozitat sipas llojit të monedhës kundrejt totalit. Depozitat në euro zënë peshën 52,2%, depozitat në lekë zënë peshën 41,6% dhe depozitat në USD zënë 5,8%.

Depozitat e siguruara të individëve për sistemin bankar që përfshijnë detyrimin për kompensim të Agjencisë ndaj kësaj kategorie depozituesish, në fund të dhjetorit të 2018-tës arritën vlerën 633,2 miliardë lekë dhe përbëjnë rreth 68,7% të vlerës së depozitave të sigurueshme të individëve. Kjo kategori depozitash ka shënuar një rritje vjetore prej 1,5%.

Depozitat e siguruara të tregtarëve dhe shoqërive tregtare gjatë vitit 2018 u rritën me 7,1% dhe në fund të vitit arritën vlerën prej 34 miliardë lekë.

Ecuria e depozitave të tregtarëve dhe shoqërive tregtare gjatë vitit 2018 ka qenë me luhatje në të dyja kahët.

Shoqëritë e kursim-kreditit në vijim të ndryshimeve ligjore të vitit 2016 janë bërë pjesë e skemës së sigurimeve të depozitave, duke u nisur nga 1 janari i vitit 2017.

Totali i depozitave të SHKK-ve në fund të vitit 2017 arriti në 6,9 miliardë lekë, nga 6,1 miliardë lekë që ishte në fund të dhjetorit të vitit 2017, duke shënuar një rritje vjetore prej 14%.

Depozitat e siguruara të SHKK-ve në fund të vitit 2018 janë 5,1 miliardë lekë, e cila përfaqëson detyrimin e Agjencisë kundrejt 14192 depozituesve në këto subjekte. Kjo shumë përbën 74% të totalit të depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit.

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Agjencia e Sigurimit të Depozitave administron tri fonde, fondin e sigurimit të depozitave në banka, fondin e sigurimit të depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit dhe që nga janari i vitit të kaluar fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në zbatim të ligjit nr. 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”.

Në vijim do t'ju paraqes një pasqyrë të përmbledhur të ecurisë së këtyre fondeve. Performanca financiare e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2018 është karakterizuar nga një rritje e qëndrueshme e fondit të sigurimit të depozitave në banka.

Në 21 dhjetor të vitit 2018 vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në banka, i cili përbëhet nga fondi themeltar prej 400 milionë lekësh dhe fitimet e akumuluar ndë vite, është 38,9 miliardë lekësh. Në krahasim me një vit më parë, ky fond është rritur me 3,89 miliardë lekë ose 11,11%.

Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2018 ishin 3,27 miliardë lekë ose 2,02% më të larta se në vitin 2017.

Të ardhura nga primet e sigurimit gjatë periudhës 2009 – 2018 kanë qenë gjithmonë në rritje dhe kjo lidhet drejtpërsëdrejti me rritjen e depozitave të siguruar në sistemin bankar në këto vite.

Nga ana tjetër, të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka për vitin 2018 ishin rreth 1miliard lekë, ose 28% më shumë se ato të vitit 2017. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i zgjerimit të portofolit në obligacione me maturitet mbi 2 vjet. Pavarësisht tendencës në rënie të normave të interesit kthimi nga investimi ka qëndruar në nivele të kënaqshme dhe si rezultat i diversifikimit të portofolit në disa maturitete.

Arben Ahmetaj – Genc, po lexon të gjithë raportin?

Genci Mamani – Jo, mbarova.

Arben Ahmetaj – Po e shikoj se je i përpiktë dhe gjithë prezantimi yt është edhe në raport, pra është mot a mot. Kam përshtypjen se nuk po bën një përmbledhje të raportit.

Genci Mamani – Kam edhe fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Arben Ahmetaj – Je te faqja e 8 e raportit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Genci Mamani – Dua të shtoj edhe një tregues të rëndësishëm të skemës, i cili është raporti i mbulimit. Ky raport është 1% e llogaritur e fondit të sigurimit të depozitave në banka me totalin e depozitave të siguruar në banka, i cili u rrit me 5,83%. Ky është një tregues shumë i rëndësishëm që tregon fortësinë e skemës dhe ecurinë në rritje të fondit të sigurimit të depozitave në banka.

Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Siç e përmenda më lart, Agjencia e Sigurimit ka përgjegjësinë ta administrojë fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka. Më 31 dhjetor të vitit 2018 vlera kontabël e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme ishte 636,7 milionë lekë. Mjetet financiare të këtij fondi janë të investuara të gjitha në letra me vlerë të qeverisë shqiptare, depozita 1 javore dhe llogari rrjedhëse pranë Bankës së Shqipërisë.

I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj anëtarë,

Këta ishin treguesit kryesorë të institucionit gjatë vitit 2018. Në raport mund të gjeni informacion më të detajuar për secilën nga këto rubrika.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, mbetem në dispozicionin tuaj për çdo pyetje, komente apo rekomandim që lidhet me veprimtarinë e Agjencisë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zotit drejtor!

Unë kam disa pyetje. Një pjesë e tyre i keni në raport, por qëllimi im është të theksojmë disa parametra të fondit të sigurimeve, por edhe të politikës së sigurimit të depozitave, duke iu referuar detyrimit ligjor.

Në raport ju thoni se 94% e depozituesve individë janë brenda limitit të sigurueshëm, pra janë të siguruar nëpërmjet fondit të sigurimeve. Për t’iu referuar qytetarëve shqiptarë, sistemi bankar është i shëndoshë dhe është i monitoruar nga Banka e Shqipërisë në mënyrë themelore, kapilare dhe të plotë. Pra, depozitat e qytetarëve janë të garantuara, jo vetëm nga shëndetshmëria e sistemit bankar, por edhe nga skema e sigurimit të detyrueshëm. Dua ta ritheksoj se 94% e depozituesve janë plotësisht të siguruara nga fondi i sigurimit. Kjo është një shifër domethënëse. Në lidhje me këtë shifër, unë kam një pyetje: si janë raportet në rajon, nëse keni informacion? E para.

E dyta, dua ta ritheksoj, megjithëse e theksuat se i thithë fondi i skemës, këtu flasim për sigurimin e detyrueshëm, shkon në 39 miliardë, afërsisht, edhe ndërhyrja e jashtëzakonshme në 633 milionë. A mund ta elaboroni se çfarë do të thotë kjo për depozituesit dhe për komisionin? Pra, kemi një raport, të cilin dua ta shprehni në përqindje, ta krahasoni me rajonin dhe të na jepni trajektoren ndër vite se si ka ecur ky raport mbulimi, siç iu referuat ju ka një rritje vjetore prej 5,7%.

Pyetja konsektive është: cila është arsyeja që është rritur? A ka sigurim vullnetar në sistem? ...

Faleminderit!

Genci Mamani – Faleminderit, zoti kryetar!

Në vijim të komentit dhe të pyetjeve tuaja mund t’ju rikorformoj atë që ju thatë, se depozitat janë të sigurta, jo vetëm nga shëndeti i sistemit bankar dhe nga qëndrueshmëria e tij, por edhe nga siguri i detyruar që vjen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Në vijim të pyetjes suaj mund t’ju them që skema është e detyrueshme, të gjithë anëtarët dhe subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë janë të obliguar për të qenë anëtarë të skemës së sigurimit të depozitave. Në Shqipëri nuk ka skema vullnetare, disa vende të tjera mund t’i kenë këto skema, por përgjithësisht skemat janë obligatore...

Arben Ahmetaj – Më falni, që po ju ndërpres!

Unë gjithmonë u referohem depozitave me shuma që kalojnë nivelin e mbulimit të detyrueshëm, pra më shumë se 2,5 milionë lekë. Doja t’ju bëja një pyetje tjetër, por meqë ju referuat në mënyrë korrekte dua të di nëse mendoni se ka ardhur koha për të futur edhe sigurimin vullnetar për pjesën që kalon shumën 2,5?

(Diskutime pa mikrofon)

Genci Mamani – Në vijim edhe të pyetjes suaj të mëparshme për nivelin e mbulimit, dua t’ju them se niveli i mbulimit në masën 94% i depozituesve deri në nivelin maksimal të mbulimit aq sa e lejon ligji në masën 2 500 000 lekë, është një nivel shumë i pranueshëm. Në raport me rajonin ne jemi në nivele të mira, duke qenë se rajoni ynë paraqet një situatë të ngjashme financiare me atë të vendit tonë...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Në rajon luhetet në masën 93, 95, 96 në këto nivele...

Arben Ahmetaj – Po në shumën relative?

Genci Mamani – Sa i takon shumës relative jemi afërsisht me atë të Bosnjës, të Maqedonisë, të Serbisë...

Arben Ahmetaj – Nëse 94% e depozituesve janë të siguruar sa është shuma totale e siguruar plotësisht edhe në raport me totalin?

Genci Mamani – Përgjithësisht, skemat e sigurimit të depozitave mbulojnë një numër të konsiderueshëm depozitash, standardet ndërkombëtare e lejojnë deri në masën 85%, por rajoni

ynë është mbi 80%, kështu që ne jemi në raporte të ngjashme me rajonin. Nga ana tjetër në vlerë lihet një shumë e konsiderueshme e totalit të depozitave jashtë skemës.

Pra, ne jemi brenda parametrave të standardeve ndërkombëtare që rregullojnë skemat e sigurimit të depozitave.

Arben Ahmetaj – Ju i referoheni shifrës në raport, nëse ajo është korrekte, 68,7% e shumës totale të individëve? Unë ju kërkova këtë dhe dua të di nëse është tamam kështu.

Genci Mamani - Kjo është në linjë, por edhe me rajonin ne jemi pak a shumë...

Arben Ahmetaj – Mua më duhet në linjë me shëndetshmërinë e financave të qytetarëve.

Genci Mamani – Absolutisht, është një shifër shumë e kënaqshme.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Genci Mamani – Depozitat e siguruar në raport me totalin e depozitave të sigurueshme janë rreth 68,7% deri në 69%.

Arben Ahmetaj – A ka ndonjë pyetje?

Fjalën e ka zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Në raport ju keni edhe një seksion të veçantë për administrimin e risqeve, madje që prej vitit 2015 në agjencinë tuaj ka një sektor të veçantë që merret pikërisht me identifikimin, monitorimin dhe marrjen e masave për të minimizuar efektin e këtyre risqeve. Aktualisht doja të dija se cili është rreziku më serioz, më i madh apo cilat janë rreziqet, nëse ka më shumë se një, me të cilat përballet agjencia apo tregu që ju monitoroni? Çfarë masash keni marrë ju si agjenci, më specifikisht ky sektor i veçantë për të minimizuar efektin e këtyre risqeve?

Faleminderit!

Genci Mamani – Po, ne kemi krijuar një sektor të analizës së riskut dhe jemi në monitorim të vazhdueshëm për të gjitha risqet që vijnë edhe nga aktiviteti i institucionit, por risku është si pasojë e mungesës së eksperiencës në një situatë reale kompensimi. Ne në Shqipëri asnjëherë nuk kemi pasur një rast, një ngjarje sigurimi, pasi, siç e tha edhe kryetari, sistemi bankar është i shëndetshëm dhe asnjëherë nuk ka prodhuar një krizë.

Është fat i madh që kemi këtë lloj risku...

Arben Ahmetaj – Shpresoj që mos ta keni kurrë këtë lloj eksperience. Mos e konsideroni risk, por konsiderojeni si dhuratë nga politikat gati 30-vjeçare të të gjitha qeverive në funksion të sistemit bankar. Është ëndërr e keqe ajo.

Genci Mamani – Është e vërtetë, por ne gjithsesi duhet të përgatitemi...

Arben Ahmetaj – Patjetër që duhet të përgatiteni, por me raporte.

Genci Mamani – Vitin e kaluar kemi realizuar dy simulime, ku qëllimi kryesor ishte rritja e gatishmërisë operacionale dhe ngritja profesionale e stafit për të përballuar ngjarje potencialisht të mundshme, të cilat shpresojmë të mos ndodhin.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Zoti Bushati, kishit pyetje?

Ervin Bushati – Faleminderit!

Vitin e kaluar patëm një lëvizje sinkron të Bankës së Shqipërisë, të cilën ne e mbështesim, po ashtu mbështetet edhe nga FMN-ja dhe Banka Botërore, për të orientuar si kreditë dhe depozitat drejt monedhës vendase...

Arben Ahmetaj – Edhe të qeverisë, zoti Bushati. Kjo ka qenë iniciativë e qeverisë...

Ervin Bushati – E lashë ëmbëlsirën për në fund, zoti kryetar.

Arben Ahmetaj – Jo duhet të jesh korrekt me qeverinë, sepse shoh që shpesh devijon.

Ervin Bushati – Doja të dija si e ka ndryshuar kjo strukturën e depozitave, si e shihni ju si lëvizje dhe çfarë mendoni se do të ndodhë në terma më afatgjatë me strukturën e depozitave të shqiptarëve të orientuara drejt monedhës vendase?

Faleminderit!

Genci Mamani – Ne si Agjenci e Sigurimit të Depozitave i kemi mbështetur masat e ndërmarra nga Banka Qendrore për të ulur përdorimin e euros në ekonomi, duke u angazhuar në fushata sensibilizimi dhe në të gjitha takimet dhe aktivitetet tona kemi parashtruar dhe u kemi bërë me dije grupeve të interesit, që përdorimi i valutës kryesisht i euros paraqet rrezik, pasi ata nuk janë në gjendje të menaxhojnë rrezikun që vjen nga ndryshimi i kursit të këmbimit.

Për të parë efektin në strukturën e depozitave është ende herët, si edhe efektin që rrjedhimisht shkon në skemën e sigurimit të depozitave, gjithsesi mund të vërehet që në depozitat e depozituesve deri në nivelin maksimal të mbulimit situata është qartazi në favor të lekut në raport kryesisht me euron. Euro më shumë ka përdorim tek tregtarët dhe shoqëritë tregtare, kjo ndoshta nga natyra e punës së tyre, biznesi apo eksport-importi me vendet e Bashkimit Europian.

Unë mendoj se ky efekt me anë të këtyre masave të depozituesi në këto vlera deri në nivelin maksimal të mbulimit është qartazi në nivelet 60% me 40% në favor lekut.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk është se kemi ndonjë shifër ideale. E rëndësishme është që njerëzit të jenë të ndërgjegjësuar se përdorimi i lekut u krijon atyre qetësi, ndërkohë që përdorimi i euros mund t'u shkaktojë humbje të paplanifikuara dhe të pallogaritura. Kjo është pjesa jonë për ndërgjegjësimin e njerëzve në atë çka favorizon leku, sepse nëse të ardhurat i marrin në lekë atëherë edhe shpenzimet duhet t'i bëjnë në lekë dhe në këtë mënyrë nuk kanë pse të kenë kokëçarje nga ndryshimet e kursit të këmbimit.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Unë ju bëra një pyetje, por ju nuk iu referuat. Fondi i sigurueshëm është 5,8% më i lartë se viti i kaluar. A është kështu?

Genci Mamani – Kjo ka të bëjë me raportin, me mbulimin...

Arben Ahmetaj – Me raportin e mbulimit?

Genci Mamani – Po, është 5,83%, një përqindje që llogaritet...

Arben Ahmetaj – Cila është arsyeja që kemi një raport më të përmirësuar? Kjo vjen për shkak të përmirësimit të skemës suaj, për shkak të raportit dhe depozitave që kanë ndryshuar, në çfarë kahjeje; të forcimit të sistemit bankar dhe reflektimi në sjelljen e individëve dhe të kompanive? Cilat janë arsyet? Nëse keni arsye të kuantifikuara do të ishte shumë mirë.

Genci Mamani – Arsyeja është rritja e fondit të depozitave në banka nga dy faktorë, primet që paguajnë bankat për të siguruar depozitat dhe të ardhurat që sigurojmë ne nga administrimi i mjeteve financiare. Kjo rritje ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e këtij raporti mbulimi dhe sa më lartë të jetë ky raport mbulimi aq më e fortë dhe efikase është skema e sigurimit të depozitave.

Arben Ahmetaj – Pyetja e fundit.

Fjalën e ka zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Në përfundim, pas këtij raportimi që ju bëtë dhe raportit që na keni dorëzuar, si dhe pyetjeve dhe përgjigjeve, cili është përfundimi? A do të kemi një sistem më të stabilizuar në krahasim me një vit të parë të sigurimit të depozitave? Pra, të gjithë këta tregues që përmendët ju, çfarë dëshmojnë? Në këtë mënyrë ne arrijmë në një përfundim që kjo punë është

në rregull dhe ka ecur apo keni ndonjë shqetësim apo problem që ne duhet ta rregullojmë?
Përmendët të gjithë këto tregues pozitivë, cili është konkluzioni juaj?

Genci Mamani - Si konkluzion mund të themi se të gjithë këto shifra, që faktikisht janë në rritje, tregojnë qëndrueshmëri të skemës së sigurimit të depozitave dhe rrjedhimisht kjo rritje e qëndrueshme shkon direkt në kontribut të stabilitetit financiar të vendit dhe qetësisë së depozituesve, të cilët sigurohen nga kjo skemë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Mamani!

Dua që të mos e hiqni nga goja kur komunikoni me publikun që 94% e individëve në Republikën e Shqipërisë i kanë depozitat 100% të garantuara, për shkak të shëndetshmërisë së sistemit bankar, për shkak të skemës që funksionon në mënyrë gati perfekte dhe në përgjithësi i gjithë sistemi financiar që funksionon edhe si integruar, por edhe në korsi të veta.

Faleminderit!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.05.2019, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Raporti i veprimtarisë vjetore të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2018.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Dritan Bici, Evis Kushi, Ervin Bushati, Anastas Angjeli, Vullnet Sinaj, Arben Elezi, Senida Mesi, Ambra Barova

Mungon:

Illir Xhakolli

Të ftuar:

Evis Shurdha – Kryetare e Komisionit të Prokurimit Publik

Brunilda Ali - Inspektore në Komisionin e Prokurimit Publik

Arben Ahmetaj - Siç e thamë, në pikën e dytë të rendit të ditës është raportimi i Komisionit të Prokurimit Publik. Të ftuar kemi zonjën Evis Shurdha kryetare e Komisionit të Prokurimit Publik, dhe Brunilda Ali, inspektore.

Sot do të dëgjojmë raportimin, javën e ardhshme do të kemi seancën e pyetjeve, të komenteve dhe rezolutës.

Zonja Shurdha keni fjalën.

Evis Shurdha – I nderuar zoti Ahmetaj,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Komisioni i Prokurimit Publik, në zbatim të detyrimit ligjor për raportimin vjetor para Kuvendit, ka dorëzuar raportin vjetor të aktivitetit të tij për vitin 2018 dhe në vijim ju paraqes një përmbledhje të tij.

Komisioni i Prokurimeve Publike, referuar përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 9643 të vitit 2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”, shfaqet në cilësinë e organit më të lartë administrativ, në shqyrtimin e ankesave në fushën e prokurimeve publike, procedurave të koncesionit, partneritetit publik privat, ankandeve publike dhe procedurave konkurruese të dhënies së lejeve minerare. Raporti vjetor është një nga format nëpërmjet të cilave pasqyrohet veprimtaria e këtij institucioni, realizohet llogaridhënia para Kuvendit dhe niveli i nevojshëm i përngjashmërisë. Ky raport është njëkohësisht një ndër argumentet dhe faktet se ky institucion pasqyron dhe bën publike veprimtarinë e tij.

Parimet themelore të funksionimit të tij, përveç parimeve të përgjithshme të prokurimit publik, siç janë mosdiskriminimi, transparenca dhe barazia në trajtimin e ofertuesve, përfshijnë edhe parimet e paanshmërisë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërisë në vendimmarrje, eficiencës, aksesit, karakterin publik, si edhe parimin e kontradktoritetit.

Komisioni i Prokurimeve Publike me veprimtarinë e tij luan një rol të rëndësishëm për rritjen e besimit ndërmjet palëve, nëpërmjet vendimeve të paanshme që merr, si edhe jep garancinë e mbrojtjes ligjore për të gjithë pjesëmarrësit e sistemit të prokurimit publik.

Kjo praktikë, e bazuar edhe në praktikat më të mira për rishikimin administrativ të procedurave të prokurimit, mendojmë se ka ndikim pozitiv në zhvillimin sa më të drejtë dhe efikas të procedurave të prokurimit nga autoritetet kontraktuale, duke synuar parandalimin e çdo veprimi të kundërligjshëm. që cenon interesat e operatorëve ekonomikë, dëmton transparencën, barazinë dhe konkurrencën, e mbi të gjitha, ruajtjen e fondeve publike, si edhe të shpenzimit e tyre me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë.

Gjatë vitit 2018 u realizua mandati nga Kuvendi i kryetarit të KPP-së më 26 shkurt të vitit 2018. Në periudhën tranzitore nga janari i vitit 2018 deri më 28 korrik të vitit 2018 kur anëtarët e rinj të KPP-së filluan efektivisht ushtrimin e mandatit të tyre, funksionet e KPP-së janë ushtruar nga ish-anëtarët e KPP-së. Tashmë me sigurimin e pavarësisë së KPP-së nga ekzekutivi është realizuar korniza ligjore dhe organizative e nevojshme, që siguron përmbushjen e pothuajse të të gjitha kërkesave themelore për organet dhe procedurat e shqyrtimit të Prokurimit Publik të përcaktuara nga marrëveshja e prokurimit qeveritar e vitit 1994, e OBT-së, e rishikuar në shkurt të vitit 2014 dhe nga ligji model i komisionit të Kombeve të Bashkuara për të drejtën tregtare ndërkombëtare dhe legjislacioni përkatës i BE-së.

Sipas këtyre kërkesave bazë, organi përgjegjës për sigurimin e rishikimit administrativ në procedurat e prokurimit duhet të konsiderohet si organ që ka karakter gjyqësor, të jetë i krijuar me ligj, të ketë karakter të përhershëm dhe jo *ad hoc*, juridiksioni i tij të jetë i detyrueshëm administrativisht, procedura në mes palëve të jetë e pavarur dhe të zbatojë parimin e ligjshmërisë.

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është një organ publik juridik, i krijuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”. Me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 47, datë 13.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”, u realizua pavarësia ligjore dhe institucionale e Komisionit të Prokurimit Publik nga pushteti ekzekutiv, duke u përmbushur kështu një nga angazhimet kryesore të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020, gjithashtu edhe një detyrim që rrjedh nga marrëveshjet me partnerët ndërkombëtarë, në veçanti me Bashkimin Europian dhe Bankën Botërore.

Komisioni i Prokurimit Publik deri në shtator të vitit 2018, ushtroi funksionet e tij bazuar në vendimin nr. 184, datë 17.03.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e

Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik dhe vendimin nr. 122, datë 22.02.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 659, datë 03.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik me mjete elektronike””.

Pas konstituimit, në korrik të vitit 2018, të KPP-së me të gjithë anëtarët e rinj të zgjedhur nga Kuvendi, Komisioni me vendimin nr. 596, datë 12.09.2018 miratoi rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilën përcaktohen rregullat e hollësishme të procedurave dhe të funksionimit të këtij Komisioni. Në ushtrimin e funksioneve të tij, ky Komision e mbështet veprimtarinë e tij në legjislacionin në fushën e prokurimeve publike, koncensioneve/PPP, ankandeve publike dhe lejeve minerare.

Gjatë vitit 2018 KPP-ja ka bashkëpunuar dhe raportuar periodikisht pranë Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme në kuadër të planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, në lidhje me angazhimet e marra përsipër për të përmbushur në mënyrë eficiente direktivat e BE-së në fushën e prokurimeve publike. Në këtë kuadër është dhënë kontribut për raportimin e zbatimit të kapitullit 5 të planit kombëtar për integrimin kombëtar, në vitet 2019-2021 si një ndër indikatorët kryesorë për mbështetjen buxhetore për reformën në administratën publike. Në mënyrë periodike është bërë raportimi pranë nënkomitetit të Tregut të Brendshëm dhe Konkurrencës duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit për veprimtarinë e KPP-së për periudhën janar- dhjetor 2018.

Gjithashtu, ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave lidhur me strategjinë e menaxhimit të financave publike duke kontribuar për raportimin e monitorimit 6-mujor dhe vjetor të strategjisë së menaxhimit të financave publike si angazhim për përmbushjen e indikatorit nr. 5, forcimi i sistemit të rishikimit administrativ për prokurimet.

Në ushtrimin e detyrave të tij ligjore ka bashkëpunuar në vijimësi me Agjencinë e Prokurimeve Publike, ku në bazë të legjislacioni KPP-ja ka njoftuar rregullisht ose për rastin e marrjes së vendimeve për pezullimin e procedurave të prokurimit me qëllim që këto vendime të pasqyrohen në SPE- për të mos lejuar autoritetet kontraktore në vazhdimin e mëtejshëm të procedurës.

KPP-ja, gjithashtu, ka njoftuar APP-në për rezultatet e vendimmarrjeve të saj. Në katër raste KPP-ja i ka kërkuar APP-së të marrë në shqyrtim shkeljet ligjore nga autoritetet kontraktore të konstatuara duke i propozuar kësaj të fundit nisjen e një hetimi administrativ.

KPP-ja në bashkëpunim me APP-në ka rishikuar rekomandimin për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike.

KPP-ja ka ndërvepruar në mënyrë periodike me autoritet kontraktore duke kërkuar informacion prej tyre për të realizuar në mënyrë të plotë hetimin administrativ. Ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme respektimin e këtij detyrimi ligjor nga autoritet kontraktore për të realizuar në mënyrë të plotë shqyrtimin administrativ.

Gjatë vitit 2018 KPP-ja ka dhënë asistencë nëpërmjet dhënies së mendimeve për aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për fusha që prekin procedurat e prokurimit, koncesionet ankandet dhe lejet minerare. Konkretisht KPP-ja ka përgatitur komentet në lidhje me projektvendimin e Ministrisë së Financave për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion dhe partneritet publik privat të ndryshuar, mendime në lidhje me projektvendimin e Ministrisë së Brendshme për Drejtorinë e Prokurimeve të Përqëndruara, mendime në fushën e prokurimeve dhe sigurinë në procesin e hartimit të projektligjit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Bashkëpunimi me institucionet partnere ndërkombëtare tani është pjesë e qëndrueshme e komisionit tonë.

Gjatë këtij viti janë organizuar veprimtari në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve. Në këto aktivitete stafi ka pasur mundësi të njihet dhe të shkëmbejë përvoja me të mira në fushën e prokurimit publik, si, për shembull, kapitulli shpjegues për kapitullin 5 prokurimi publik i cili u mbajt në 6 dhjetor të vitit 2018, si dhe seminarin e organizuar nga SIGMA. Për komisionerët e KPP-së. Struktura dhe organika e KPP-së si edhe numri i punonjësve dhe buxheti i Komisionit të Prokurimit Publik miratohet nga Kuvendi, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9584 “Për pagat dhe shpërblimet e strukturave të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”.

Në muajt janar – korrik të vitit 2018, në zbatim të nenit 196 të ligjit nr.9643 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar” KPP-ja ka funksionuar nëpërmjet strukturës dhe organikës së përcaktuar me urdhër të Kryeministrit nr.60, datë 12.5.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Komisionit të Prokurimit Publik”.

Struktura, organika dhe numri i punonjësve të KPP-së, në kushtet e ndryshimeve ligjore të vitit 2017, u miratuan nga Kuvendi me vendimin nr.85, datë 19.07.2018, vendim i cili i filloi efektet e veta në datën 1 janar 2019.

Në zbatim të strukturës dhe organikës së miratuar nga Kuvendi është përmbyllur procesi i ristrukturimit dhe po vijohet me procedurat për rekrutimet për pozicionet vakante.

Aktualisht, nga 30 pozicione të buxhetuara, kemi rezultuar me 6 pozicione pune vakante, përkatësisht 5 pozicione pune Inspektor në Drejtorinë e Ankesave dhe 1 pozicion pune Drejtor i Drejtorisë së Ankesave. Aktualisht, 16 prej tyre janë femra dhe 8 janë meshkuj.

Gjatë vitit 2018, struktura e Komisionit të Prokurimit Publik, ka trajtuar një numër të lartë ankesash të paraqitura nga operatorë të ndryshëm ekonomikë duke marrë pjesë njëkohësisht në projekte të ndryshme në dobi të rritjes së cilësisë dhe kredibilitetit në institucione si dhe duke dhënë kontribute në mënyrë direkte ose indirekte në përmirësimin e legjislacionit shqiptar në fushën e prokurimeve publike.

Pavarësisht nga numri i vogël i stafit, në raport me detyrat dhe volumin e punës me të cilat duhet të përballet, KPP-ja duke punuar me frymën e ekipit, si dhe duke organizuar e racionalizuar me eficiencë burimet njerëzore, ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në raportimet periodike për procesin e integritetit dhe përafrimin e legjislacionit me direktivat e BE-së në lidhje me fushën e prokurimeve publike.

Çdo nëpunës civil i institucionit ka kryer trajnimin e detyruar pranë Shkollës shqiptare të Administratës Publike dhe është konfirmuar si i tillë. Për sa u përket trajnimeve sipas profileve përkatëse të pozicionit të punës kanë kryer trajnime të specializuara gjithsej rreth 12 punonjës, pra 50% e stafit.

Vlerësimi i rezultateve të punës së punonjësve dhe procesi i vlerësimit të performancës së tyre është kryer sipas përcaktimeve të bëra sipas legjislacionit në fuqi.

Mbështetur në ligjin nr. 9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, në ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, si dhe në ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, procesi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit për vitin 2018, si dhe situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit të institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik për periudhën janar-dhjetor paraqitet si vijon:

- Shpenzimet e përgjithshme bazuar në buxhetin e vitit 2018 kanë arritur në vlerën 35 milionë e 628 mijë e 900 lekë nga 37 milionë e 100 mijë lekë të parashikuara në buxhetin për vitin 2018, duke realizuar në masën 96 % të planit vjetor.

- Mund të konstatojmë që situata ekonomike gjatë vitit 2018 për KPP-në ka qenë e qëndrueshme dhe optimale. Janë realizuar pothuajse të gjithë zërat e buxhetit brenda masës së planifikuar në projektbuxhetin afatmesëm 2018-2020.

- Shpenzimet dhe investimet më të rëndësishme dhe të domosdoshme për KPP-në janë realizuar me efikasitet duke bërë që edhe puna të vijojë me efektshmëri duke plotësuar nevojat e punonjësve për një mjedis të përshtatshëm pune.

Ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik bëhen kundrejt pagesës, parashikuar në nenin 63, pika 10 e ligjit nr. 9643 “Për prokurimin publik”. Rregullat dhe tarifat e pagesës deri më sot përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në rastet kur në fund të procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës, ankimimi i një operatori është pranuar, vlera e tarifës financiare të paguar i kthehet ankimuesit, ndërsa në rastet kur në fund të procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës, ankimimi i një operatori nuk pranohet, vlera e tarifës financiare derdhet 100% në buxhetin e shtetit. Në total, shuma prej 36 milionë e 052 mijë e 622 lekësh i është kthyer operatorëve ekonomikë ankimues, të cilëve u është pranuar ankesa në bazë të vendimeve të marra, ndërsa shuma prej 69 milionë e 369 mijë e 416 lekësh, që rezulton nga vendimet jo në favor të ankimuesve, ka kaluar në buxhetin e shtetit. Dy shumave të mësipërme u shtohet edhe një tjetër shumë prej 8 milionë e 369 mijë e 629 lekësh, të cilat janë arkëtuar nga KPP-ja gjatë vitit 2018, vendimet e të cilave janë marrë në vitin 2019. Rrjedhimisht, tarifat financiare të paguara nga këta operatorë ekonomikë janë rimbursuar gjatë vitit 2019.

Referuar sa më sipër, KPP-ja ka realizuar 113 milionë e 791 mijë e 967 lekë gjatë vitit 2018 si të ardhura jashtëbuxhetore. Në analizën e të dhënave statistikore rezulton se 111 milionë e 175 mijë e 672 lekë nga totali i të ardhurave jashtëbuxhetore ose 97.7 % e të ardhurave janë tarifat e mbledhura për ankesat për procedurat e prokurimit publik, vijuar me tarifat e tjera që janë: për procedurat e koncesionit, të ardhura nga tarifat minerare dhe për procedurat e ankandeve publike.

Aktualisht, KPP-ja nuk mban asnjë pjesë të të ardhurave të arkëtuara nga ankimuesit e pasuksesshëm, të cilat, në qoftë se edhe pjesërisht do të mbeteshin si fonde të KPP-së, do të bënin të mundur realizimin e një sërë objektivave për rritjen e cilësisë dhe kapaciteteve profesionale të KPP-së.

Komisioni i Prokurimit Publik respekton parimet e ligjshmërisë, barazisë dhe mosdiskriminimit, pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje, shpejtësisë dhe eficiencës, qëndrueshmërisë në vendimmarrje, aksesin dhe karakterin publik dhe kontradiktorialitetin gjatë shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë.

Anëtarët dhe punonjësit e komisionit, si dhe ekspertët e pavarur, ku përfshihet procesi në ushtrimin e detyrave të tyre, në kuadër të një procedure vendimmarrëse për shqyrtimin e një ankese, ruajnë të dhënat personale dhe të dhënat që lidhen me sekretet shtetërore dhe tregtare.

Në zbatim të nenit 64, pika 3 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar” ku nga shqyrtimi në themel i ankesës para lidhjes së kontratës KPP-ja gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e ligjit për prokurimin publik, ai ka të drejtë të disponojë duke vendosur: të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjor; të anulojë plotësisht ose pjesërisht një vendim ose veprim të autoritetit kontraktor; të udhëzojë autoritetin kontraktor, të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vijojë me procedurën e prokurimit ose të urdhërojë anulimin e procedurës për shpalljen e kontratës fituese.

Pas lidhjes së kontratës, kur KPP-ja gjykon si një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e ligjit për prokurimin publik, ka të drejtë të nxjerrë një interpretim në lidhje me rregullat ose parimet ligjore, ose të marrë një vendim deklarativ, në bazë të së cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankimuesin.

Referuar ligjit për prokurimin publik, KPP-ja përgatit raportin vjetor, i cili duhet të përmbajë numrin total të të dhënave mbi numrin total të ankimimeve dhe vlerën e tyre për secilin autoritet kontraktor.

Gjatë periudhës 1 janar deri më 31 dhjetor 2018, në Komisionin e Prokurimit Publik janë regjistruar 1158 ankesa në total, prej të cilave 1148 ankesa janë paraqitur për procedurat e prokurimit publik, 2 ankesa për procedurat konkurruese koncesione/PPP, 5 ankesa për procedurat e ankandit publik dhe 3 ankesa për procedurat konkurruese leje minerare.

Për sa u përket ankesave të procedurave të prokurimit publik, nga totali 1148 ankesa, 268 janë paraqitur për procedura prokurimi mallrash, 195 për prokurim shërbimesh, 71 për prokurim të punëve publike dhe 614 janë ankesa të paraqitura për shërbimin e ruajtjes së sigurisë fizike.

Gjatë vitit 2018, vijon që numrin më të madh të ankesave ta zënë ato në lidhje me procedurat e prokurimit për ofrimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe shoqërim të vlerave

monetare me 614 ankesa nga 1145 në total ose 53.6 % duke shënuar një rritje të vogël krahasuar me 50% që ka qenë pesha e këtyre ankesave në vitin 2017.

Sqarojmë se KPP-ja ka dalë me vendimmarrje gjatë vitit 2018 për 1145 ankesa nga 1158 ankesa të depozituara. Pra, numri 884 i vendimeve, si numër rendor përfshin 843 vendime për shqyrtim në themel dhe 41 vendime për çështje procedurale administrative.

Sqarojmë se përveç 1158 ankesave të regjistruara, gjatë vitit 2018 janë mbartur edhe 76 ankesa të depozituara në vitin 2017 për të cilat janë marrë 52 vendime gjatë vitit 2018.

Gjatë vitit 2018 është vënë re një rritje e numrit të ankimeve administrative të paraqitura pranë KPP-së, krahasuar kjo me vitin 2017, ku janë dorëzuar 1999 ankesa.

Duke krahasuar numrin e ankesave të depozituara, gjatë vitit 2018 vihen re një rritje rreth 0.94 % ndaj atyre të vitit 2017.

Në një vështrim krahasimor, në muajin mars të vitit 2017, që është viti me më shumë ankesa, ka pasur 219 ankesa, në vitin 2018 ka pasur 280 ankesa, ndërkohë, që në muajin shtator ka qenë numri më i ulët i ankesave.

Për sa u përket treguesve lidhur me shpejtësinë e shqyrtimit të ankesave nga KPP-ja, gjatë vitit 2018 rezulton një përmirësim i ndjeshëm në tremujorin e fundit të këtij viti me rreth 74% të ankesave të shqyrtuara brenda afatit, krahasuar me 45% për vitin 2017. Ky ritëm i tremujorit të fundit të vitit 2018 vijon të ruhet edhe gjatë vitit 2019.

KPP-ja ka vijuar me konsolidimin e praktikës në drejtim të trajtimit të ankesave të paraqitura jashtë afatit duke mbajtur në konsideratë faktin se respektimi i afateve, ndër to edhe ai i ankimit është i një rëndësie thelbësore me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës.

Gjatë veprimtarisë së vitit 2018 janë evidentuar gjithashtu 10 raste me mungesa të kushteve formale, që janë paraqitur pa paguar tarifën përkatëse krahasuar me 7 të tilla të paraqitura në vitin 2017.

Gjatë vitit 2018 pranë KPP-së janë paraqitur ankesa nga 315 autoritete kontraktore, nga 1388 të tilla që janë regjistruar në sistemin e prokurimeve publike. Komisioni i Prokurimit Publik ka marrë vendime lidhur me ankesat e paraqitura për procedura, të cilat në total, referuar fondit limit të prokuruar, arrin një vlerë prej 18 miliardë e 828 milionë e 414 mijë e 336 lekësh, nga totali prej 129 miliardë e 819 milionë e 994 mijë e 300 lekësh

të publikuara për prokurim, pra 14.5 % e fondit limit total të publikuar për prokurim është shoqëruar me ankesa në KPP për procedurat përkatëse.

Nga 8814 procedura të publikuara për prokurime, ankande dhe koncesione për 840 ose për 9.5% të tyre janë paraqitur ankesa në KPP. Të dhënat e plota të detajuara i keni në aneksin nr. 1, që është shoqëruar me raportin.

Gjithashtu, autoriteti që ka numrin më të lartë të ankimimeve, sipas fondit limit dhe sipas procedurave, edhe këto janë pjesë e raportit.

Lidhur me vendimmarrjen e KPP-së janë depozituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, 85 kërkesë-padi, kundrejt 843 vendimeve në total, të marra nga komisioni gjatë vitit 2018. Nga këto kërkesë-padi, vetëm njëra është nga një autoritet kontraktor, ndërsa të tjerat janë të gjitha kërkesë-padi të operatorëve ekonomikë.

Në përfundim të procesit gjyqësor në shkallë të parë gjykata ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë për kundërshtimin e 7 vendimeve të KPP-së, ndërkohë që është vendosur lënia në fuqi e 46 vendimeve të KPP-së nga totali i 85 vendimeve të ankimuara. 31 procese janë akoma në vijim.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, ka mbajtur të njëjtin qëndrim me KPP-në në 85% të vendimeve të ankimuara, një përmirësim i ndjeshëm ky duke u krahasuar me 70% të rasteve të ankimuara për vitin 2017.

Duke mbajtur në konsideratë faktin që shumica e vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë ka rezultuar në favor të vendimeve të KPP-së, një tregues pozitiv është edhe rënia e ndjeshme nga 50 në 24 e vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë, të ankimuar në Gjykatën e Apelit nga paditësit. Kjo tregon se për paditësit ka mjaftuar vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për t'i bindur për ligjshmërinë e vendimeve të KPP-së, të kundërshtuara prej tyre. Gjithashtu, tregon për një konsolidim të qëndrimeve qoftë të KPP-së, qoftë të gjykatave për rastet e ngjashme.

Vlen të përmendim nëse marrim në konsideratë kërkesë-paditë, që janë ende në proces shqyrtimi, qoftë në gjykatën e Shkallës së Parë, qoftë në atë të apelit në vlerë absolute gjykatat kanë rrëzuar vendimmarrjen e KPP-së rreth 18,9% të rasteve për vitin 2017 dhe vetëm në 8,3 % të rasteve për vitin 2018. Kjo qëndrueshmëri e gjykatave në konfirmimin e vendimmarrjeve të KPP, ka ndihmuar mjaft edhe në konsolidimin e praktikës nga ana e KPP-së për mbajtjen qëndrimeve të njëjta për rastet e ngjashme apo të njëjta, që i paraqiten për shqyrtim.

Në bazë të parashikimeve të ligjit “Për prokurimin publik”, të drejtën për të paraqitur ankesë pranë Komisionit e ka çdo person që ka, ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me ligjin dhe që autoriteti kontraktor pas paraqitjes së ankesës prej tij:

- a) nuk ka shqyrtuar ankesën brenda 7 ditëve nga marrja e saj;
- b) ka refuzuar ankesën; c) ka vendosur mospranimin e ankesës.

Me marrjen e ankesës me shkrim, Komisioni i Prokurimit Publik sigurohet që autoriteti kontraktor e ka pezulluar procedurën e prokurimit.

Pas një shqyrtimi paraprak të ankesës për plotësimin ose jo të kushteve formale siç janë respektimi i afatit, pagesa e tarifës, respektimi i formës së parashikuar nga ligji për paraqitjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vendos nëse do të vijojë me shqyrtimin në themel të saj dhe respektivisht për vijimin ose jo të pezullimit të procedurës.

Në shqyrtimin në themel të ankesave, në varësi të fazës së procedurës së prokurimit për të cilën ato janë paraqitur, KPP-ja rast pas rasti ka shqyrtuar ankesa në të cilat kanë pasur si objekt respektimin e kërkesave të ligjit dhe akteve nënligjore, të lidhura kryesisht me:

a. Për ankesat e paraqitura për dokumentet e tenderit:

- Respektimin e rregullave për përcaktimin e fondit limit sipas fushës që i përket objekti i prokurimit;
- Respektimin e rregullave për përzgjedhjen e llojit të procedurës sipas kufijve përkatës monetarë përkatës;
- Respektimin nga autoritetet kontraktore të kërkesave të ligjit për hartimin e specifikimeve teknike sipas përcaktimeve në nenin 23 të ligjit të prokurimit publik;
- Respektimin e rregullave për hartimin e kërkesave dhe dokumenteve provuese në lidhje me kriteret e kualifikimit;
- Ruajtjen e zbatimit të parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rastet kur autoritetet kontraktore në hartimin e kërkesave të cilësisë, vendosin kërkesa të tepërta, të panevojshme ose pa lidhje me objektin e prokurimit për certifikime e akreditime kombëtare ose ndërkombëtare.

Për vitin 2018, nga 1158 ankesa në total, 225 prej tyre ose 19,43 % janë ankesa të paraqitura për dokumentet e tenderit. Nga këto, 91 janë ankesa për dokumentet e tenderit të paraqitura në procedura prokurimi për shërbimet e ruajtjes fizike.

Në këto rrethana, unifikimi dhe bërja e detyrueshme e një pakete kriteresh minimale të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për procedura të njëjta ose të ngjashme, do të rezultonte me një ulje të ndjeshme të numrit të ankesave me këtë objekt.

b. Ankesat e paraqitura për fazën e vlerësimit të ofertave janë për këto raste:

- Skualifikim i padrejtë dhe i pabazuar në ligj dhe në rregullat e prokurimit i ankimuesit nga ana e autoriteteve kontraktore për mospërbushje të kriterëve kualifikuesë dhe/ose specifikimeve teknike;

- Kualifikim i padrejtë dhe i pabazuar në ligj dhe në rregullat e prokurimit i ofertuesve të tjerë të ndryshëm nga ankimuesi, duke u anashkaluar kërkesat e vendosura nga vetë autoritetet kontraktore për përmbushje të këtyre kriterëve;

- Mosrespektimi i rregullave për njoftimet dhe komunikimin me pjesëmarrësit në një procedurë prokurimi;

- Mosrespektimi i afateve dhe procedurave të kualifikimit dhe përzgjedhjes nga autoritetet kontraktore, duke kërkuar anulimin e procedurës.

Për vitin 2018, nga 1158 ankesa në total, 916 prej tyre ose 79,1 % janë ankesa të paraqitura për fazën e vlerësimit të ofertave.

Nga totali i 17 ankesave ose 1,47 % e totalit të ankesave janë ankesa të paraqitura në lidhje me anulimin e shortit për procedurat për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë.

Problematikat e identifikuara në funksionimin e sistemit të ankimimit për prokurimin publik ...

Arben Ahmetaj – Zonja Shurdha, po lexoni raportin?

Evis Shurdha – Jo, kam bërë një përmbledhje, meqë jo të gjithë e kanë raportin.

Arben Ahmetaj – Të gjithë e kanë raportin. Përveç komisionit tonë, këtë raport e ka marrë edhe Kryesia e Kuvendit.

Evis Shurdha – Unë kam bërë një përmbledhje për ato që janë më të rëndësishme për t’u thënë.

Arben Ahmetaj – Dakord. Kaloni te konkluzionet!

Faleminderit!

Evis Shurdha – Në zbatim të rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2018”, në kuadër të marrjes së masave për rritjen dhe për forcimin e aftësive dhe kapaciteteve profesionale të anëtarëve të KPP-së, në datën 18

dhjetor është zhvilluar trajnimi me temë: Sfidat dhe ndikimi i punës së KPP-së në sistemin e prokurimit publik të organizuar nga SIGMA.

Për sa i përket pikës 2 të rezolutës, për shqyrtimin e ankesave brenda afateve ligjore, KPP-ja ka marrë të gjitha masat ligjore për shqyrtimin e ankesave sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Siç e thashë edhe më lart, respektimi i afateve është në fokusin e punës së Komisionit, por zbatimi rigoroz i tyre ka qenë i vështirë gjatë vitit 2018, duke pasur në konsideratë vonesën në konstituimin e komisionit të ri dhe faktin që për mbi 1 muaj vendimmarrja e KPP-së ka qenë e pezulluar në pritje të fillimit efektiv të punës. Sidoqoftë, pas shtatorit 2018 shikohet një tendencë pozitive për konstituimin plotësisht të KPP-së me anëtarë të rinj.

Për sa i përket pikës 3, KPP duke mbajtur parasysh parashikimet ligjore të ligjit nr. 9643, merr vendime mbi ankesat e depozituara, duke mbajtur parasysh përveç parimeve të përgjithshme, edhe parimin e paanësisë në shqyrtimin e ankesave.

Një tregues mjaft i mirë është edhe qëndrueshmëria në rritje e vendimmarrjes nga ana e gjykatave administrative.

Në lidhje me pikën 4, që është realizuar plotësisht, kemi bashkëpunuar me APP-në, si menaxhuese e SPE-së. Në bazë të dispozitave të legjislacionit KPP-ja ka njoftuar rregullisht APP-në në lidhje me procedurat e prokurimit.

Në lidhje me pikën 4, KPP-ja, si organi më i lartë për shqyrtimin e ankesave bashkëpunon me agjencinë, si organi që ndërmerr nismat për ndryshimet ligjore në fushën e prokurimeve publike dhe për sa i përket hartimit, ndryshimit të legjislacionit në këto fusha. Më konkretisht, kemi dhënë komente në lidhje me projektligjin për prokurimet në fushën e mbrojtjes e të sigurisë, në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së.

Në lidhje me pikën 5, ka ruajtur të njëjtën qëndrueshmëri për marrjen e vendimeve për rastet e njëjta apo të ngjashme, duke treguar profesionalizëm.

Në lidhje me pikën 6, kemi përfunduar ristrukturimin dhe jemi në proces rekrutimi për stafin vakant.

Në lidhje me pikën 7, për sa i përket hartimit të planit afatmesëm strategjik, mendojmë se kjo kërkon një ekspertizë specifike edhe në kuadër të ndryshimeve ligjore që do të bëjmë në lidhje me harmonizimin e të drejtës së brendshme së bashku me atë të BE-së.

Në lidhje me pikën 8, jemi akoma në proces.

Në lidhje me pikën 9, KPP-ja ka miratuar rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” me vendimin nr. 596/2018.

Në lidhje me pikën 10, për përmirësimin e afateve ligjore të shqyrtimit, është në bashkëpunim të vazhdueshëm duke raportuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe APP-së.

Në lidhje me pikën 11, KPP-ja publikon në faqen e saj zyrtare në çdo kohë të gjitha njoftimet, rekomandimet, ankesat dhe vendimet përfundimtare në kohë reale, duke u ardhur në ndihmë autoriteteve dhe operatorëve ekonomikë.

Vlen të përmendim se numri i ankesave ka qenë në rritje, si pasojë e rritjes së besueshmërisë në sistemin vendimmarrës të KPP-së.

Objektivat për të ardhmen

Objektivi kryesor dhe konstant i KPP-së është mbrojtja e interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve kontraktore në zbatimin e ligjshmërisë, në lidhje me prokurimin publik.

KPP do të vijojë t’i kushtojë rëndësi të veçantë profesionalizmit, paanësisë në vendimmarrje, transparencës, efikasitetit dhe rritjes së besueshmërisë në sistemin e prokurimit publik.

Në mënyrë të veçantë, për vitin 2018, KPP-ja i ka vendosur vetes objektivat e mëposhtme:

- Kuadri ligjor për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë është i plotë dhe i qartë. Pavarësisht kësaj, paraqitet i nevojshëm hartimi nga KPP-ja i manualeve dhe materialeve shpjeguese.

- Jemi akoma në procesin e implementimit të sistemit dixhital të administrimit të ankesave, që kërkon ndryshim ligjor.

- Do të përfundojmë procesin e rekrutimit të stafit.

- Institucionet e administratës shtetërore janë më të qarta në rolin që ato kanë në zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik dhe detyrimin për të zbatuar vendimet e KPP, të cilat janë administrativisht përfundimtare. Gjithsesi, akoma më shumë punë duhet bërë në konsolidimin e kapaciteteve të rrjetit të zyrtarëve përgjegjës për prokurimin, të cilët duke qenë monitoruesit e zbatueshmërisë së ligjit, do të rrisin dhe besueshmërinë e publikut në vendimmarrjen e institucioneve të tyre.

- Përmbushja e detyrimeve takuese të KPP-së si organ i rishikimit administrativ të prokurimeve publike, në drejtim të realizimit të angazhimeve të lidhura me procesin e anëtarësimit në BE dhe raportimet periodike përkatëse.

- Përmbyllja e procesit të rekrutimit të pozicione vakante sipas dispozitave ligjore në fuqi.

- Evidentimin e nevojave për përmirësim të kuadrit ligjor në fushën e prokurimit publik, në kuadër të garantimit të pavarësisë në procesin e rishikimit administrativ.

Në drejtim të realizimit të objektivave të vet afatmesëm, KPP-ja me rastin e raportimit vjetor përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë mbi ecurinë e punës, mirëpret kërkesat, sugjerimet dhe vërejtjet eventuale nga Kuvendi, por edhe mbështetjen e nevojshme për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve, në zbatim të kompetencave ligjore të tij, si një institucion i pavarur, kompetent dhe i paanshëm.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Shurdha!

Siç e lamë komisioni do të përgatitet për pyetjet, komentet, qëndrimet dhe për rezolutën.

Do të njoftoheni nga sekretaria e komisionit për ditën e zhvillimit të mbledhjes tjetër.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti